



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 91, Datë 20.04.2018**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË  
“WIND POWER ALBANIA” SHPK, PËR LICENCIMIN E NË AKTIVITETIN E  
FURNIZIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37 pika 2, gërma “ç” të Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar si dhe në zbatim neneve 4, pika 1, gërma “d”; 5 pika 1 gërma “d” dhe 10 pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016; neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 20.04.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut; për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Wind Power Albania” sh.p.k, në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria “Wind Power Albania” sh.p.k., ka aplikuar në ERE për tu pajisur me licencë në aktivitetin e Tregut të Energjisë Elektrike, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 164 Prot., datë 07.02.2018.
- Aplikimi i shoqërisë “Wind Power Albania” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
  - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b”, “c”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “f”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për dokumentacionin e munguar, që ka të bëjë me:

- Neni 9, pika 4.7, gërma “e” (Sistemin IT)
- neni 9 pika 4.7.1 gërmat “a” (të dhënat për klientët dhe energjinë e furnizuar), “b” (Niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët) dhe “c”, (Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti), do të njoftohet subjekti që në bazë të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, t’i paraqesë ato në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Wind Power Albania” sh.p.k, në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**